
THE POETIC WORLD OF FRANCESCO SOLANO BOTA POETIKE E FRANÇESKO SOLANOS

VEBI BEXHETI

Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Macedonia
V.Bexheti@Seeu.Edu.Mk

AKTET V, 4: 754-757, 2012

PËRMBLEDHJE

Krahas veprimtarisë shkencore në fushat e dijes arbëreshe dhe shqiptare në përgjithësi, Franceko Solano nuk u largua edhe nga krijimtaria letrare. Ky autor ishte ndër poetët e parë që pas një ndërprerjeje të krijimtarisë letrare të traditës së arbëresheve të Italisë, me vepren e vet krijuese artistike shërbeu si urë lidhëse mes dy epokash, asaj të periudhës së letërsisë klasike që identifikohet me De Radën e madh, dhe asaj që rifilloi pas një ndërprerjeje kohore e që e çeli rrugën e letërsisë bashkëkohore. Pas këtij boshllëku që erdhi nga ndërprerja e vazhdimësisë krijuese letrare, me veprat e Françesko Solanos, që në krijimtari njihet me pseudonimin Dushko Vetmo, u hap një epokë e re në letërsinë shqipe të autorëve arbëreshë që vazhdon edhe sot. Françesko Solano në veprimtarinë e gjithanshme të tij, për bazë kishte jetën arbëreshe, kulturën arsimin, gjuhën e tyre si pjesë përbërëse e asaj shqipe. Ai qe i pari që pas një periudhe 23 vjeçare, kur Zef Skiroi po e përmbyllte epokën e parë të letërsisë shqipe të arbëreshëve, me botimin e poemës "Mino", e ripërtriu këtë veprimtari të ndërprerë letrare me përmbledhjen poetike: "Bubuqe t'egra", të botuara më 1946 në Buenos Aires. Poezia e Dushko Vetmos, edhe pse në frymën e poezisë së hershme arbëreshe, që përveç tjerash karakterizohet me ndikimin e letërsisë gojore, është poezi e një bote tjetërfare krijuese, që hap rrugën e poezisë bashkëkohore, e që bashkë me veprat dramatike dhe ato të prozës, e përligj edhe letërsinë bashkëkohore të arbëresheve të Italisë.

Fjalët kyçe: poezi, letërsi gojore, letërsi bashkëkohore

Key words: poetry, oral literature, contemporary literature

1. Hyrje

Dushko Vetmo është pseudonimi i intelektualit të madh arbëresh, Françesko Solano, i cili nuk pushoi së vepruari në fushë të studimeve të gjuhësisë e veçmas në ate të folmeve arbëreshe, dhe të letërsisë, ku më së tepërmi u angazhua në transkriptimin e disa veprave të rëndësishme të poetëve arbëreshë. Krahas kësaj veprimtarie shkencore, ai ishte edhe krijues. Veprimtaria letrare e tij, para së gjithash si poet, po edhe si prozator e dramaturg, në letërsinë shqipe të arbëreshëve paraqet përtëritjen e kësaj letërsie, pas një ndërprerjeje të shkurtër dhe dobësimit të aktivitetit krijues, qysh nga koha kur Zef Skiroi më 1923 e botoi poemën "Mino". Deri në botimin e përmbledhjes poetike "Bubuqe t'egra", më 1946

në Buenos Aires të Argjentinës, në letërsinë e krijuesve arbëreshë nuk ishte botuar ndonjë vepër e rëndësishme.

Veprimtaria shkencore, puna e pedagogut kur e udhhiqete Katedrën e gjuhës e të letërsisë shqipe që e kishte themeluar vetë, në Universitetin e Kozencës, dhe misioni i tij në shërbim të Zotit duke e predikuar fjalën e hyjit, në asnjë moment nuk e pengoi në krijimtarinë letrare. Përveç meritës për lidhjen e hallkës, pothuaj të shkëputur të vazhdimësisë letrare, Vetmo e ka edhe peshën e krijuesit që karakterizohet me mënyrën e perceptimit të objektit artistik të trajtuar në gjuhë, në varg dhe në tematikë.

2. Bota përshkrimore

Bota poetike e Vetmos është e mëvetësishme dhe dallon nga shumë poetë pasardhës arbëreshë. Gjuha poetike me vlerat metaforike dhe pesha e simbolit, që reflektojnë gjithanshëm, temat që trajtohen dhe mënyra e qasjes krijuese e Dushko Vetmos, vazhdimësinë e ndërprerë e rinis me disa poezi moderne, pa u shkëputur edhe nga ndikimet e saj të traditës arbëreshe. Edhe poezia e Vetmos, ashtu si ajo e tërë autorëve arbëreshë, burimin e kishte nga letërsia gojore, prandaj edhe ky varg poetik, ruajti në vete edhe ngjyrimin e krijuesit popullor. Prania e sonetit apo tingëllimës në vargun e tij e dëshmon edhe ekzistimin e elementit të formës klasike.

3. Përmbledhja poetike "Bubuqe t'egra"

Përmbledhja poetike "Bubuqe t'egra" që u botua dhe u shkrua në një vend të dytë të huaj, e ruajti origjinalitetin dhe në të nuk vërehet asnjë ndikim që këtë poezi do ta dallonte nga ato që u shkruajtën në vendin ku jetonin arbëreshët. Vetëm poetët e mirëfilltë e ruajnë botën e tyre në brendinë e shpirtit poetik. Edhe poezia e Serembes, një pjesë e së cilës u krijua në Brazil, megjithë përjetimet me pasoja të rënda për poetin, e ruajti gjithashtu ngjyrimin e ambientit të Strigarit.

Në intervistën që e bëri Anton N. Berisha me poetin Dushko Vetmo më 1998, në shtëpinë e poetit, në fshatin Frasnitë, mësojmë shumëçka nga jeta e tij në Argjentinë, për punën si udhëheqës dhe themelues i Katedrës në Kozencë, për bashkëpunimin me dy intelektualët e mëdhenj, Ernest Koliqin dhe Martin Camajn, për qëndrimin e tij në Shqipëri dhe Kosovë dhe për letërsinë që krijohet atje. Ndër të tjera, aty e përmend edhe domosdonë që edhe letërsia arbëreshe të shkruhet në gjuhën letrare shqipe. Në këtë intervistë poeti flet edhe për poezinë e vet të përmbledhjes "Bubuqe t'egra" dhe për poezinë shqipe në përgjithësi. Atë që poeti synon ta shohë çdo ditë, është mrekullia, thotë Vetmo, e ai që nuk di të mrekullohet, nuk është poet, vazhdon ai. (Anton N. Berisha, Dushko Vetmo, Vepra, f. 395). Edhe vet autori i kësaj përmbledhjeje dinte të mrekullohet nga jeta,

prandaj edhe poezitë e tij ishin vetë mrekullia, ato ishin krijuar në Frasnitë dhe ishin lindur në Argjentinë.

Përmbledhja poetike "Bubuqe t'egra" posa doli nga shtypi, ua tërhoqi vemendjen shumë intelektualëve të kohës që merreshin me letërsi. Shumë domethënëse janë edhe fjalët e vetë autorit, drejtuar lexuesit. Ai vetë tregon se fjala është për vargje me frymëzim rinor që çdo fletë të librit e lexojnë me dashuri." Kemi pandehur se kështu sado të vogël, do të bënim punë të vëllyeme për bashkimin e gjakut tënë të shprishur".

Në parathënien e këtij libri, ndër tjera lexojmë: "Dashuri e kulluem mbretnon ku do vëndi nër vjershat e këtij këngtori, dhe mandej duke i lexuar, në zënë shpirti me një bukuri tinëzore që nuk e dimi kah po vjen, por që na heq mbi një të rrëmbyeshme qiellore".

4. Motivet e poezisë së Dushko Vetmos

Poezia e Dushko Vetmos vazhdoi me një hov më të madh rrugëtimin e poezisë arbëreshe. Punën e atdheut dhe shprehjen e qenies etnike, poeti e kishte veprimtari të përditshme. Në tërë poezitë e dy përmbledhjeve të tij, vjershat që prekin në mënyrë të drejtpërdrejt këtë çështje janë shumë pak. Për një poet që i hapi dyert e poezisë moderne, ndoshta kjo temë që ishte përpunuar aq shumë në letërsinë arbëreshe të traditës, nuk ka nevojë të jetë vazhdimisht në qendër të vëmendjes. Nga vetë fakti se vjershën e parë të përmbledhjes poetike të tij, e titullon "Kushtrimi", e që ka të bëjë me dashurinë e jo me atdheun, siç është bërë traditë të nënkuptohet kushtrimi i lirisë, vihet re sensi poetik i tij, që me qëllim e bën këtë thyerje të traditës shkrimore, për të treguar se poezia mund të shkruhet edhe pa shabllone e uniformë.

Me këtë poezi, që si duket është "këngë përkushtuese", e që tregon se vepra i kushtohet dashurisë dhe i dhurohet të dashurës: "*E ty po këto kënga, tek un qesh e pshertonj/moj lule, t'i kushtonj*", autori, si duket, përmes kësaj poezie-parathënie, lajmëron ardhjen e një poezie të re në letërsinë shqipe të arbëreshëve. Këtë model të

poezisë me kuptim parathënieje e hasim edhe te Migjeni, Lazgushi dhe ndonjë tjetër.

Dashurinë për atdheun e tyre të largët që dikur jetonte vetëm më kujtesën e arbëreshëve, tanimë, kur ata kishin mundësi ta vizitojnë ate, e zbresin nga një dashuri imagjinative e qiellore, në ate reale, që paraqitet si dëshirë për ta parë atë vend dhe vëllezërit e gjuhës e të gjakut. Për poetin Vetmo, sikur tema e dashurisë për atdheun mjaftohej vetëm me poezinë me të njejtin emër, pra "Atdheut", poezi kjo që na del me fizionomi dhe brendi të ngjashme me shumë poezi tjera të letërsisë sonë të traditës, e që më së paku i ngjan kësaj arbëreshe. Fjala "Atdhe" për poetin është emër i ëmbël, është fjalë e shenjtë dhe e kthjelltë, fjalë për të cilën duruan arbëreshët dhe jo vetëm ata. Për fjalën atdhe, thotë poeti "*hilnar i madh na dhez në gji*". Ky atdhe për poetin është djepi i parë ku nëna e përkund fëmijën që shumë shpejt do ta lë vatrën dhe do nisë rrugëve të botës. Nga këta fëmijë ishin edhe poetët arbëreshë, ishte edhe poeti Dushko Vetmo që për atdheun dhe gjuhën, bëri më shumë se disa të tjerë, ai jetoj për këtë dashuri dhe është i gatshëm që për te ta japë edhe jetën: "*Për ty na, o mëmë, gjellën po e dhuromi/ Për ty te lufta nderë, lule, madhëri,/ Kërkom, o nënë, e dashura Shqipëri,/ E prap edhe për ty çdo ditë na rromi!*"

Tematika kryesore e veprës "Bubuqe t'egra" është malli apo dashuria. Shqiptimi i kësaj ndjenje këtu përafrohet me konceptin që mbretëron në poezinë arbëreshe të traditës, qoftë si strategji perceptuese qoftë si mënyrë shprehjeje dhe si vërgërim (Këtë temë e ndeshim edhe në përmbledhjen "Te praku", madje edhe në poezitë që Vetmo i përdori në pjesët teatrale (Anton N. Berisha, Interpretime letrare..., f. 299) Kjo temë, pra ajo e dashurisë që shtrihet në tërë vargun e dy përmbledhjeve poetike të Dushko Vetmos "Bubuqe t'egra" dhe "Te pragu", në konceptin e tij krijues poetik dallon nga shumë poetë tjerë që këtë lloj poezie e shkruanin të shtyrë vetëm nga ndjenja e brendshme e fuqishme që e ndjenin për të dashurën. Dashuria e Vetmos është më e madhe se kaq, ajo reflekton në shumë segmente të jetës dhe merr përmasa

më të mëdha se një dashuri, ajo është vetë jeta, kënaqësia, qetësia shpirtërore e lumturia, por edhe hidhërimi, lëndimi, shpresa, mallëngjimi, etj. Për këtë dashuri poeti vuan e digjet si qiriri i Naimit, gëzohet si Zef Serembe kur te sheshi pa ate që e kërkonte, dhe ashtu i vetmuar : *pranë zjarrit*, në vatër i krusur përgjon si lokja e Mjedës kur *ulëron përjashta \ me tërbim stuhie.* \, por që me këtë personazhe dhe fatin e saj dallon në thelb sepse nuk e pret vdekjen, por të dashurën që ia ka dëgjuar zërin. Ai nuk e thërret vdekjen por jetën, apo atë që jep jetë, ai dëshiron që së bashku me të dashurën që nuk duket, por që është shndërruar në zë, të shkojnë *së bashku nëpër dushqet e njoma \ të pyllit dhe rrerën e ngrohtë të detit.* Vargjet: *Eja \ le të shkojmë së bashkut \ në gjirin e ujërave të fshehta \ të jetës,* dëshmojnë edhe një herë për rëndësinë e metaforës së vargut të tij dhe reflektimet e botës së brendshme, drejt asaj universale me tërë fshetësitë e jetës. Ashtu si shumë poezi, edhe kjo është fryt i imagjinatës dhe zgjedhjes së fjalës, shprehjeve e ngarkesave dhe e nuansave të tyre kuptimore shprehëse të cilat ndërlidhen me njëra tjetrën dhe si të tilla bëjnë strukturën përkatëse gjuhësore, që është teksti poetik (shih te Anton N. Berisha, po aty, f. 373). E këtu është poezia me titull "Dy elegji" që dëshmon se vargjet e poezisë së Dushko Vetmos ngjajnë më shumë me ato të autorëve tjerë, por që njëherit edhe dallojnë me shumëçka nga ata. Dielli, hëna, yjtë, që në këtë poezi të fuqishme simbolizojnë gjallërinë dhe jetën, një ditë nuk do të jenë, lulet do të bëhen gurrë, ndërsa në momentin kur pritej të mbarojë çdo gjë e gjallë mbi tokë, do të ketë diçka më të fuqishme se dielli e hëna, do të jetë drita e saj që do të qëndrojë e vetme: *Drita jote do të qëndrojë / dhe rrufeja në flakë / kasollen time do ta shndërrojë.* Filozofinë e jetës dhe të vdekjes poeti e spjegon me fuqinë e dashurisë, nëse ajo nuk vdes, edhe po të mbetet e vetme në botën e vdekur, jeta do të përtrihet me lule dhe flutura, e nëse ajo e dashuron ate, do të bëhet dritë e do të vallëzojë: *përmbi ballin, përmbi flokët, përmbi qiellin, përmbi tokën (Dy elegji).*

Me gjithë ngjashmëritë që poezia e Vetmos ka me shumë vargje të poetëve tjerë, që krijuan në

shtrirje të ndryshme kohore e hapësinore, origjinaliteti i saj mbetet i paprekshëm. Në poezitë "Lule" dhe "Malli i parë" të përmbledhjes "Bubuqe t'egra", vërejmë një ngjajshmëri të madhe me poezinë "Më të bukurës në Strigari", të Zef Serembes. Nëse ky i fundit që po priste te sheshi u gëzua kur e pa ate që e donte: *po kjo zemër u gëzua, kur një vashë mu afrua, kur te sheshi ajo shkonte, tërë sheshit dritë i lshonte*, Dushko Vetmo gëzohet kur e pa vashën faqekuqe: *e pe një faqe-kuqe; thash: imja ka të jetë, /o Zot kjo burbuqe*. Në takimin e parë me poetin, kjo vashë ia shpoi zemrën si shigjetë dhe i iku duke e lënë të vuajë, ashtu si vajza e bukur e Strigarit që bashkë me prindërit u largua në Brazil duke e lënë këtë të plagosur: *tashi, si zog i zi, / unë kërcenja mbi nga fole / dhe ture thrritur rri:/ "O malli 'im, ku je? (Z.Serembe, "Malli im i parë")*.

5. Përfundim

Meqë Dushko Vetmo merrej me studime të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe si profesionist kur ishte profesor dhe udhëheqës i katedrës, edhe në krijimtarinë poetike e kishte parasyshë rëndësinë e gjuhës shqipe, prandaj ai shkruajti për afërsisht në gjuhën letrare të kohës, para dhe pas Kongresit të Drejtshkrimimit. Ai shkruante poezi për gjithë shqiptarët, prandaj në veprat e tij hasim shprehje dialektore që mund ta mbulonte tërë shtrirjen gjeografike shqiptare. Shembull më tipik për përdorimin e gjuhës shqipe në tërë hapsirat shqiptare, tregon edhe poezia "Gjumi i trazuar". Vajza, e vetmja personazhe e poezisë, në vargjet në vijim do të paraqitet me katër emrat: vashë, cucë, çikë dhe çupëz. Jo rastësisht poeti e zgjodhi emrin e vajzës që është karakteristike për nga kuptimi sinonimik.

Metafora, simbolika dhe ngjyrimet tjera të shumta kuptimore, këtë poezi e bëjnë ndër më të bukurat estetikisht dhe ndër më të thellat për nga kuptimi figurativ poetik. Kjo vajzë që fle në djepe malli *e par si borë nën hënën / sytë' i shkëlqejn' e balli*, si duket nuk është një vajzë e vogël, edhe pse aty përmendet djepi, që me siguri në këtë rast ka kuptim metaforik, e kjo më së miri shihet në strofën e fundit ku zbulohet se ky djep është dashuria: *E butë tash hëna një sqepë / prej qiellit mbi djepë lishoj, dh'e qëlluar vasha përsëri / n'atë djepë – dashuri qindroj*. Kjo vajzë që në strofën e dytë paraqitet si vashëz: *vashëz i këndojnë për dore*, në strofën e katërt si cucë: *cucës, tuij e nderr nër qiell*, në ate të tetën si çikë: *prap çikën m'e zgjuan* dhe në të nëntën si çupëz: *mos çupëz po fle*, është vetëm një shembull që dëshmon pasurinë e kësaj gjuhe dhe bukurinë kur ajo është në shërbim të vargut poetik, siç është edhe ky i Dushko Vetmos

Bibliografia:

- BERISHA, Anton N. (2007), *Vepra letrare e Dushko Vetmos*, përgatitur nga Anton N. Berisha, me vërejtje të Françesko Altimarit, Kozencë.
- BERISHA, Anton N. (2008), *Interpretimet e letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, Kozencë.
- JORGAQI, Nasho (2001), *Antologji e poezisë bashkëkohore arbëreshe*. Zgjedhur dhe përgatitur nga Nasho Jorgaqi, Tiranë.
- VETMO, Dushko (1946), *Bubuqe t'egra*, Bojnós Aires, 1946, ribotuar në librin e cituar
- VETMO, Dushko (1977), *Te praku*, Botimet e rrethit, 1977, ribotuar në librin e cituar.